



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 30 / 2024

Datë: 16 / 02 2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 17 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MD - Nr. 21/2023 për Procedurën për Punësimin, Pezullimin dhe Lirimin e të Dënuarve nga Puna, si dhe shpërblimin për punën e të dënuarve, Ministria e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Shuma e shpërblimit mujor për punën e kryer nga i/e dënuari/a i/e angazhuar në punë profesionale në Institucionet Korrektuese është tridhjetepesë (35) euro.
2. Shuma e shpërblimit mujor për punën e kryer nga i/e dënuari/a i/e angazhuar në punë teknike në Institucionet Korrektuese është tridhjetë (30) euro.
3. Shuma e shpërblimit mujor për punën e kryer nga i/e dënuari/a i/e angazhuar në punë mbështetëse në Institucionet Korrektuese është njëzetepesë (25) euro.
4. Obligohet Shërbimi Korrektues i Kosovës për procedimin e ekzekutimin të shpërblimit mujor për punën e kryer nga personat e dënuar të angazhuar në punë sipas kategorizimit të punës të përcaktuar në nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MD - Nr. 21/2023 për procedurën për punësimin, pezullimin dhe lirimin e të dënuarve nga puna, si dhe shpërblimin për punën e të dënuarve.
5. Transaksionet financiare lidhur me punën e të dënuarve të procedohen dhe administrohen në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi i'u dërgohet:

- *Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;*
- *Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Njësisë për Buxhet dhe Financa;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*